Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Konferencë me Media – Java e I-rë në terren e Regjistrimit të Popullsisë (ReKos 2024)

08 prill 2024

Në ambientet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) sot u mbajt një Konferencë me Media lidhur me ecurinë e punës në terren që nga fillimi i Regjistrimit të Popullsisë (ReKos 2024) më 5 prill 2024.

U.d. Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së, Avni Kastrati, tha se "Procesi i Regjistrimit të Popullsisë në Kosovë ka filluar më 05 Prill dhe do të zgjasë deri më 17 Maj 2024. Procesi i Regjistrimit të Popullsisë është duke u zhvilluar sipas planit. Këto ditë, stafi në terren ka zhvilluar aktivitet e parapara (njoftimi me zonë regjistruese, shpërndarja e materialeve informuese dhe kontaktuese tek ekonomitë familjare, si dhe ka zhvilluar disa intervista nëpër ekonomi familjare). Aktualisht mbi 90% e stafit që është kërkuar si regjistrues dhe 98% e mbikëqyrësve janë në terren gjatë këtyre ditëve. Tek komuniteti serb në disa pjesë ka hezitim për pjesëmarrje, por shpresojmë që ditëve në vijim do të ndryshojnë me qëllim që të jenë pjesë e këtij projekti madhor".

Sa i përket pajisjeve ato janë në nivel të lartë dhe duket se janë shumë funksionale, nuk kemi hasur në ndonjë problem. Edhe hartat digjitale, po ashtu janë në nivel dhe deri më tani është duke funksionuar sipas planit.

"Po ashtu, sistemi është duke funksionuar mirë, që ka qenë një brengë për këto ditët e para.
Sistemi i monitorimit dhe kontrollit gjithashtu është zhvilluar dhe është funksional.
Që nga tani, pritet që zhvillimi i intervistave të intensifikohet sipas një plani dinamik të paraparë" - tha z. Kastrati.

Gjatë këtyre ditëve janë zhvilluar intervista me të gjitha komunitet.

Z. Kastrati u bëri thirrje çdo qytetari të Kosovës nga cilido komunitet që të marrë pjesë në Regjistrim, pasi është në interesin e secilit individ, secilës zonë, vendbanim, komunë, përfshirë institucionet qendrore, sepse Regjistrimi, përveç që është obligim qytetar, ai është edhe obligim ligjor. Qëllimi nuk është që të panalizohen qytetarët, por pjesëmarrja është e domosdoshme për të pasur shërbime më të mira.
Mos-regjistrimi do të nënkuptojë mos-mundesi per ofrimin e shërbimeve.

Më pas, gjatë konferencës u bë edhe një prezantim nga z. Burim Limolli, udhëheqës i IT në ASK, rreth monitorimit të regjistruesve në terren dhe për numrin e intervistave të kryera gjatë këtyre ditëve.
Ndërkaq, për anën ligjore foli edhe prof. Mazllum Baraliu.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) do të mbajë Konferenca për Media çdo të hënë përgjatë gjithë periudhës sa zgjatë Regjistrimi i Popullsisë në terren.